



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIJË**

Nr. 2592/Prot.

Tiranë, më 19.042024

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1082, datë 06.11.2007.

**SHOQËRISË “PAKTI” SH.P.K
Lagjja “Gjeologu”, Nr. 15, Bulqizë, Dibër.**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA**

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “PAKTI” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1082, datë 06.11.2007, për mineralin krom, në Objektivin “Pusi 1 (Galeria 52-104)”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

Nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 1700, datë 18.03.2024, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 2592, Prot., datë 18.03.2024, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1082, datë 06.11.2007, për mineralin krom, në Objektivin “Pusi 1 (Galeria 52-104)”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, për arsyet të rradhitura si më poshtë:

1-Materiali teknik i depozituar pranë AKBN-së, në mbrojtjen e projekt-programeve për vitet 2022-2023 dhe 2023-2024, nuk përputhet me gjendjen faktike në terren.

Informacionet që subjekti i ka dhënë AKBN-së, lidhur me punimet minerare dhe prodhimi i realizuar për vitin 2023, janë të pavërteta/të pasakta, me informacionet që subjekti i ka dhënë AKBN-së. Planimetritë me frontet e punës të parashikuara dhe të realizuara për të dyja vitet janë të njëjta me njëra-tjetrën. Në frontet e paraqitura për prodhimin e realizuar për vitin 2023, rezultoi se Nk II, Nk III, Nk IV, Nk V, nga horizonti i galerisë Nr. 104, H+874, nuk është zhvilluar aktivitet mineral dhe nuk është prodhuar mineral në këto fronte.

2-Subjekti, në dosjet e programeve vjetore të viteve 2022-2023 dhe 2023-2024, sipas aneksit Nr. 2, ka deklaruar se ka shpenzuar 825,000 lekë për rehabilitimin e mjedisit për secilin vit. Nga verifikimi në terren rezulton se, subjekti nuk ka kryer asnjë proces për rehabilitimin e mjedisit, duke bërë që ky informacion i dhënë në kuptim të ligjit mineral të jetë i pavërtetë.

3-Subjekti ka penguar grupin e punës në ushtrimin e funksioneve të inspektimit për verifikimin e stokut të mineralit edhe pas marrjes së njoftimit zyrtar.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “gj” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 47, pika 1, gërma “gj”, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr.1082, datë 06.11.2007, për mineralin për mineralin krom, në Objektivin “Pusi 1(Galeria 52-104)”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, që shoqëria Juaj zotëron.**

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesni sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare. Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1082, datë 06.11.2007, për mineralin krom, në Objektivin “Pusi 1(Galeria 52-104)”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ENKELEJDA MUÇAJ

